

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-2

A.58

FATMIRA  
ALIAJ  
E fejuara  
ime  
DRAMË

814-2  
A58

FATMIRA ALIAJ

# E FEJUARA IME

dramë




SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LALIA AHIMTAJ

E FETUARAVE

Shpreh



Tirazhi 1000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1977

## PERSONAZHET :

- ANDROMAQUI — 60 vjeç me origjinë punëtore, tani pensioniste, shkurt e thërresin Maqi.
- LENA — vajzë e Maqit, 19 vjeçe, punëtore.
- NASI — i fejuari i Lenës, teknik në byronë teknologjike, 28 vjeç.
- FLUTURA — shoqe e Lenës, punëtore, 20 vjeç.
- ANDONI — i ati i Nasit
- VASILIKA — e ëma e Nasit
- ARBENI — shok i Nasit
- LIRIA — kryetare e kooperativës në fshatin A.

Kooperativistë e kooperativiste.

## PJESA E PARË

### Tablo e parë

Dhomë ndënjeje e rregulluar thjesht e bukur. Në një kolltuk Maqi duke thurur triko, në tjetrin Nasi pi cigare.

NASI — (I shqetësuar sheh orën.) Ora vajti pesë, shumë u vonua.

MAQI — Duke ardhur duhet të jetë. Më tha se kishin një mbledhje me shumë rëndësi.

NASI — Mbledhje me rëndësi?! Përse?!

MAQI — Ku e di unë, more bir. Po edhe sikur të ma kishte thënë se mos do të më kujtohej përse. Kaq mbaj mend unë. (Qesh e thekson.) Mbledhja është me shumë rëndësi. Të tjerat, pastaj... Ato i zgjidhni vetë ju.

NASI — Nuk thashë ndonjë gjë ja, po... Nuk u mbaruan, ndonjëherë këto mbledhje të shkreta, se mbledhje sot, mbledhje nesër... Apo jo?

MAQI — E po, edhe ato duhen, mor bir.

NASI — Po xhanëm, po! Nuk them, po edhe sikur të mos i ndjekësh të gjitha mbledhjet nuk bëhet kiameti. E kush do ta vërë re Lenën në vajti a s'vajti?!

Se mos kanë rënë mbi kokë të saj problemet e ndër-marrjes. Mirëpo hajt t'i thuash Lenës të mos shkojë, pa të shohësh.

MAQI — E po, shoqja me shoqe, bir, nuk ndahen.

NASI — Ato nuk ndahen, po edhe ti, mama... Ti nuk ia prish kurrë, bile edhe nga punët e shtëpisë e ke li-ruar fare.

MAQI — Po unë nuk kam si ta shkëpus nga shoqë-ria, pastaj dhe e vogël nuk është tani. E kupton ve-të të mirën dhe të keqen.

NASI — (Shëtiti nëpër dhomë si i menduar.) Unë kam një mendim, nënë Maqi.

MAQI — Hë, mor bir, thuama!

NASI — Nuk di si do të ma presësh edhe ti...

MAQI — Pse, nga unë varet?

NASI — Po, po, edhe nga ju. Mund të them në radhë të parë nga ju.

MAQI — (Lë punën e dorës dhe shikon dhëndërin.) Pa ta dëgjojmë, o bir.

NASI — Them ta marr Lenën që këtë verë...

MAQI — Uuu, kaq shpejt?!

NASI — Martohemi e shpëtojmë, Ç'të presim më.

MAQI — Ti ke thënë se do ta marrësh nga viti tjetër, e tani po shpejtohesh?

NASI — (Duke qeshur.) Po pse mos pret të të rritet akoma?

MAQI — (E menduar.) Jo, jo... unë nuk pres, po...

NASI — (I pret fjalën.) Më falë që të pres fjalën, por të moshuarit thonë se po kaloi vajza të 16-tat, leze-tin e ka në shtëpi të burrit dhe jo në derë të baba-it.

MAQI — (Vë buzën në gaz.) Ashtu ishte njëherë e një kohë, po tani mendojmë ndryshë. Pastaj, Lenën e

kam të vetme, e nuk do ta nxjerr nga shtëpia si vajzë të gjetur, ë?

NASI — (Buzagaz.) Nuk ma merr mendja të mos i kesh bërë gjë ti. Kushedi sa vjet ke që përgatitesh për Lenën.

MAQI — Ah, more bir, unë i kam rritur fëmijët jetimë. Këta të dy më mbetën pa babë që në vegjëli. I kam rritur me mundime, me këta krahë i kam përballuar vetë të gjitha.

NASI — Rritja e fëmijëve me mundime bëhet.

MAQI — Po, veç ka mundime dhe mundime. Nuk them, dhe ju për bukën e gojës keni vuajtur, po u rritët me baba gjallë. E mua dy fëmijët e parë më kanë vdekur. Tani do të ishin njëri 38 vjeç e tjetri 36... Fukarallëk thuaj, ja! Të ikte fëmija e ti nuk kishe si t'i bëje derman. Vdiste fukaraja dhe as e çante kokën njeri për të. Nikja, i vogli, ishte në gji në kohë të bombardimeve. Njërin e kisha tre vjeç, këtë në gji, burri partizan në mal. . . Këta donin të hahnin: Lëre mos e nga!

NASI — E po, kohë luftë, nënë...

MAQI — Po nuk ishte vetëm ajo, kur linda të parin nuk ishte luftë, e bëra tre vjeç dhe e futa në dhe. Eh, shqyr iku ajo kohë... Po Lena ç'thotë, mor bir? Në një mendje me ty është?

NASI — Lenës nuk e kam thënë gjë.

MAQI — A, domethënë e nise nga unë, ti?! (E vendosur.) Jo, këtë verë nuk e martoj dot.

NASI — Për harxhet e ke fjalën?

MAQI — Për të gjitha... As mua, as juve nuk ju shtrëngon kush. Verës tjetër...

(Troket dera, shkon e hap dhe hyjnë Lena e Flutura.) Po hë, moj Lena, na bëre merak! Kemi dy orë që po të presim.

- LENA — Mirëmbërëma, Nasi! (I jep dorën, pastaj i drejtohet së ëmës.) Mirëmbërëma, nënoke! (E merr për qafe.)
- FLUTURA — (Pasi përshëndetet me Nasin shkon tek Maqi.) Mirëmbërëma, teto Maqi! Vërtet u merakosët?
- MAQI — Jo, moj bijë, jo!
- LENA — Ah, çfarë mbledhje ka qenë? Po ju, Nasi, si s'patët mbledhje sot?
- NASI — Nuk na lajmëroi njeri, po mund të kemi nesër.
- LENA — Me siguri që do të bëni.
- MAQI — Po uluni, çupat e nënës, se do t'ju ketë marrë uria. T'ju sjell për të ngrënë. (Bën të ngrihet po nuk e lë Lena.)
- LENA — (Një dorë në sup të së ëmës.) Jo, nënë, jo, nuk duam, hëngrëm në mensë në kohë të pushimit.
- MAQI — Atëhere t'ju bëj nga një kakao apo nga një çaj?
- FLUTURA — Çaj më mirë.
- NASI — (Ulet karshi Lenës.) Dy orë?
- LENA — (Duke qeshur.) T'i kam borxh.
- NASI — (Buzagaz.) Kur do të ma lash borxhin?
- LENA — Që nesër...
- NASI — Unë them më mirë sonte. Apo je e lodhur nga mbledhja. Nuk na thatë përse e kishit mbledhjen?
- LENA — Mbledhja që për t'u solidarizuar me iniciativën e të rinjve të uzinës mekanike për të punuar e jetuar....
- FLUTURA — Një vit në fshat.
- NASI — Me dëshirë, sigurisht.
- LENA — Sigurisht...
- MAQI — Vullnetarë, moj bijë? Apo është fjala për djemtë? Të venë si të mos venë? Djem janë e po nuk



shkuan ata kush do të vejë? Unë?! Të venë, si të mos venë?

FLUTURA — Nuk është fjala vetëm për djemtë, teto Maqi.

MAQI — (Shikon Lenën.) Po qysh është, moj bijë?

LENA — (Me buzë në gaz.) Fjala është për të rinjtë dhe rinia nuk ka vetëm djem, por ka edhe vajza.

MAQI — (Lenës e Fluturës.) Ç'flisni, moj bija? Vajzat nuk janë si djemtë. Djali po djalë! Ku rafsha mos u vrafsha djali. Vajzat kanë halle, pa fejohen, pa martohen, pa lindin fëmijë... Ehu, puna e vajzave ndryshon.

FLUTURA — Teto Maqi, si thua ti, vetëm djemtë të shkojnë vullnetarë edhe kur na bëhet thirrje të ndihmojmë fshatin?

MAQI — Ku dini ju nga punët e bujqësisë, moj bijë!

FLUTURA — Do të mësojmë. Pse, kush ka lindur i ditur?

NASI — Ashtu është, shumë drejt, po ka dhe përjashtime. Dhe përjashtimi nuk e prish rregullin.

LENA — (Serioze). Për ç'përjashtim e ke falën, Nasi?

FLUTURA — (Duke buzëqeshur.) Unë mendoj se Nasi e ka fjalën për të sëmuret e për ata që fizikisht nuk i përballojnë dot vështirësitë e fshatit.

NASI — Për ata e për të tjerë. (Lenës.) Për shembull, ti je vajzë e vetme me nënë plakë, me provime, etj, etj. Pra e ke shumë të vështirë, të mos them të pamundur.

LENA — Thirrja nuk bëhet me kondita.

NASI — Shumë e drejtë, duhet t'u prgjigjemi kërkesave të kohës dhe detyrat që marrim përsipër t'i çojmë deri në fund. Po ju, si vendosët? Kjo ka rëndësi! U kërkuan mendimin bashkarisht, si organizatë, apo një nga një?

- LENA — (Me të qeshur.) Më duket se paske harruar si bëhen mbledhjet e organizatës. Kjo do të thotë se ke shumë kohë që s'ke vajtur.
- NASI — Vërtet, e kam me gjithë mend... Mos qesh tani. Si?
- LENA — Fare e thjeshtë, dhamë fjalën si organizatë.
- NASI — Hë... Ashtu thuaj.
- LENA — Si hë?
- NASI — Domethënë problemi nuk shtrohet konkretisht për ty.
- LENA — Problemi shtrohet se fshati tani ka më tepër nevojë për krahë pune dhe ti e di mirë rolin e bujqësisë në forcimin ekonomik.
- NASI — (Me të qeshur.) Shih, shih, qenke bërë agjitatore e fortë, Lena! Shyqyr që je e fejuar, thuaj, e nuk të cakton njeri.
- LENA — Unë dëshirën e shfaq, bile edhe Flutura.
- MAQI — Mirë, moj bijë, ato që thotë Partia të bëhen që ç'ke me të, po fundja le të venë djemtë dhe vajzat beqare, po jo të fejuarat si Lena e të martuarat si ti. Hë, po edhe për ato beqaret hall është se do të mbeten pa martuar, të gjorat. Për djemtë është kjo punë, e di unë, se ata nuk mbeten pa martuar.
- FLUTURA — Pse, moj teto Maqi, një vit është, dhe vajzave nuk u ikën koha. Pastaj, me shokë venë atje e në punë e sipër njihen e, në fund të fundit... dhe fshati ka djem.
- NASI — Ç'thua, moj Flutur? Paska edhe djem fshati! Po kur ka mundësi të martohet në qytet? Pastaj, qytetarja e ka më të vështirë jetën në fshat, është mësuar ndryshe.
- LENA — (Fluturës.) Më fal, Flutura! (Nasit.) Po dhe ndonjë çudi nuk është: siç martohen nga fshati në qytet, mund të martohen, natyrisht, kur gjen njeri-

- un, edhe nga qyteti në fshat. Ja, unë për shembull, të ishe ti në fshat pse nuk do të të merrja?
- NASI — (I tërhequr.) A, më fal Lena, më keqkuptove. Unë e them thjesht nga jetesa, nga rrethanat, nga jeta e përditshme... Me pak fjalë, thjesht teknikisht.
- LENA — (Dashmirëse.) Ti je në byronë teknologjike, Nasi, po kujdes mos bjer në teknokratizmë, se do të të vemë në shënjestër pastaj..
- FLUTURA — Mua më falni! Kam lënë takim me Fatmirin.
- LENA — Akoma me takime ti? (Flutura ngrihet.)
- NASI — Po ne do të dalim një shëtitje?
- LENA — Si të duash. Ja sa të përcjell Fluturën.
- Lena e Flutura në paraskenë.
- FLUTURA — Moj, ai Nasi ia këput kot ndonjëherë. Apo bën shaka?!
- LENA — Ty si t'u duk?
- FLUTURA — Si m'u duk?! Po ti e njeh më mirë, Lenka! Natën e mirë! (Ikën.)
- LENA — (Qëndron pak e heshtur.) Natën e mirë! (Kthehet në dhomë dhe ullet.)
- NASI — (I qeshur.) Mirë, moj Lenka, unë dhe mamaja ende nuk e morëm vesh si dolët nga ajo mbledhje?
- LENA — (Me shaka.) Si të gjithë shokët e shoqet e tjera, nga dera.
- NASI — Hej, nga dera! Me zotimin për në fshat, flas.
- LENA — Gjithë grupi ynë vendosi të shkojë për të punuar vullnetarisht një vit në fshat.
- NASI — E ti?
- LENA — Edhe unë si gjithë të tjerët, megjithëse u thashë se do të pyesja edhe familjen.

NASI — Shumë mirë, Lenka! Ja, këtu je treguar e zgjuar!

MAQI — (Lenkës.) Të keqen nëna, ashtu duhet! (E sheh të mërzhitur.) Dhe për këtë mërzhitësh ti?

LENA — Më erdhi rëndë, se vetëm unë u tregova e lëkundur.

NASI — Unë e përsëris se qëndrimi yt ka qënë mjaft i pjekur. Tani ka mundësi që të tërhiqesh me lezet.

LENA — E si të tërhiqem?

NASI — Ja, kollaj fare: u thua, siç u shprehe edhe në mbledhje, kam shumë dëshirë që të mos ndahem nga kolektivi, të mos mungoj nga ky aksion me kaq rëndësi e të tjera e të tjera, që sigurisht do t'i plotësosh vetë, por, për arsye se në verë do të martohem, dhe dy muaj janë... e unë sa të shkojë edhe të kthehem pas dy muajve, nuk ka kuptim. Sigurisht që ata do të të kuptojnë drejt.

LENA — Ua! Po unë gjer më tani u kam thënë ndryshe e tani t'u them se do të martohem?

NASI — Po fundja edhe martohemi... Pse?! Këtu nuk ka asgjë të keqe, për t'u martuar kemi një ditë, me këtë rast mbyllim dhe këtë shteg.

MAQI — Mirë thotë, të keqen nëna!

LENA — Jo, moj mama, nuk thotë mirë. (Nasit.) Dhe ti, Nasi, martesën tonë kërkon ta përdorësh si një lesë për të mbyllur shtegun e vajtjes në fshat?

MAQI — Ngadalë, moj bijë, ç'të gjeti?!... Sikur do të martohesh sonte dhe ti! Ai për të mirë ka menduar. Pas fejesës vjen martesa. Edhe unë i thashë Nasit sikur ishte shpejt, dhe aq më tepër që s'jemi të pregatitur, por tani ti e sheh...

LENA — Ç'farë shohë, mama?! Ky është një kurth që ne e pregatisim vetë. Apo...

NASI — (I pret fjalën.) Ç'ka këtu për «apo», Lena?... Këtu janë dy gjëra: vajtja në fshat dhe martesë. Ne duhet të zgjedhim më të rëndësishmen. Prandaj, Lena, shikoi gjërat më me gjakftohtësi edhe të tjerët gjykoi më me drejtësi.

LENA — Jo, Nasi, këto dy çështje janë të ndara: fshati ka punën e vet dhe martesë të vetën... Pastaj, kush paska vendosur të martohemi në verë?! Unë nuk di gjë! Apo lindi tani ky mendim e s'pati nevojë të pyetesh unë.

NASI — Asnjëri nuk ka vendosur, Lena, jo! Ne po themi si na bëhet më mirë, kurse ti shqetësohesh e merr zjarr kot. Ja, po të pyesim: a nuk është më mirë të martohemi këtë verë?

LENA — Jo, Nasi, ne do të martohemi mbasi të kthehem unë nga fshati.

NASI — E pse?

LENA — Që të mos thonë shokët se u martova para kohe sepse desha t'i dredhoja fshatit.

NASI — Ama, për fjalët e botës do të merakosemi ne?

LENA — Po mirë, atëherë, edhe ne mund të martohemi dhe unë të shkoj siç po shkon Flutura. Ja, edhe ajo e martuar është.

NASI — (E ndërpret.) Si the, si the? Të martohemi dhe të shkosh në fshat? Këtu më duket se fole pa u menduar mirë. Po ne pikërisht për të mos shkuar në fshat, do ta shpejtojmë martesën. Është rasti.

LENA — Jo, Nasi! Ti duhej të ishe i pari që të më përkrahje dhe jo të më mësosh të gënjej.

NASI — Po mirë, mirë... Unë i përkrah mendimet e tua dhe veprimet, por kur ato më duken të drejta. Pastaj, kur ato nuk marrin udhë se ty të duken kështu e mua ashtu, burri yt jam unë dhe, pa vendosur edhe unë, ti nuk mund të vepros për asgjë... Sigu-

risht, ti nuk duhet të mendosh aspak se unë nuk i vlerësoj mendimet e tua; por, duke qenë shumë e re, ka mundësi që të biesh lehtë në gabime.

LENA — (Gjakftohtë.) Unë akoma nuk jam gruaja jote.

MAQI — Mbylle, moj vajzë, pse flet kështu?! Dëgjoje burrin se di më shumë se ti.

NASI — Lena, mos u revolto; unë nuk desha që të të fyej dhe sigurisht që do të marr edhe mendimin tënd për çështje që do të na dalin në jetë, por ka gjëra jo se i kupton shtrembër, por nuk arrin t'i kuptosh mirë. E kjo vjen se je shumë e re, jetën nuk e njeh sa duhet, po ndodhin dhe përplasje të tilla në jetë, që, për t'i zgjidhur, barra i bie burrit.

LENA — (E inatosur.) Mos u shqetëso kaq shumë për çështjet e mia, jam në gjendje t'i zgjidh vetë.

NASI — (Duke parë Lenën të zemëruar tërhiqet.) Dëgjo Lenka, ti je vajzë e zgjuar, gjykoje punën me gjakftohtësi. Mendohu mirë sonte dhe nesër përsëri bisedojmë. (Ngrihet për të dalë.)

MAQI — Ashtu, bir i nënës, ashtu! Mirë thua, se edhe kjo ka ardhur e lodhur nga mbledhja e nesër do të jetë më e qetë.

LENA. — Unë e qetë jam dhe sot dhe, po të them, në isha gjer tani në mëdyshje dhe në organizatë thashë se do të pyesja dhe familjen, tani e vendosa: unë do të kërkoj të shkoj në fshat me grupin e parë.

NASI — Ou?! Për inatin tim duket, ë?

LENA — Jo për inat, po ashtu e ndiejë, që duhet.

NASI — Unë të them mendohu dhe një herë, sa...

LENA — Se do të jetë vonë, do të thuash.

NASI — Ou, Lenka! Me ty nuk u bisedoka sonte. Natën e mirë!

MAQI — (Së bijës.) Dil e përcille!

NASI — Jo, iki vetë.

## Tablo e dytë

Skena: Zyra e kooperativës bujqësore. Troket dera.

KRYETARJA — Hyr!

NASI — (Hyn.) Mirëdita!

KRYETARJA — (Ngre kokën dhe përshëndet.) Mirëdita!

NASI — Ju jeni kryetarja e kooperativës?

KRYETARJA — Po, unë jam, urdhëroni!

(Nasi hyn, i jep dorën dhe ajo i zgjat dorën.)

NASI — Si jeni shoqja kryetare? Me punë si shkoni?

KRYETARJA — Faleminderit, mirë! Po, më falni...

NASI — (E ndërpret.) Po ju sigurisht nuk më njihni.

Jam Nasi Ilia, i fejuari i Elena Shtegut që ka ardhur vullnetare për një vit në kooperativën tuaj. Është në grupin e punëtorëve të uzinës.

KRYETARJA — (Mendohet pak.) Po, po! E njoh.

Është në grupin e atyre që kanë ardhur tani vonë. Urdhëroni, uluni!

NASI — (Ulet në një karrige.) Një muaj ka që ka ardhur, shoqja kryetare.

KRYETARJA — (Buzëqesh.) Ju, besoj, keni dëshirë ta takoni. Ja, dërgojmë dhe e thërresim.

NASI — Jo, jo, falemnderit! Kam ardhur për tjetër punë. Dua të bisedoj me ju për një çështje me rëndësi familjare.

KRYETARJA — (E trembur.) Ka ndodhur gjë në familje?

NASI — Jo, asgjë e keqe. Ju thashë që e kam të fejuar.

KRYETARJA — (Duke qeshur.) Po, po! Më thatë...

NASI — Ju lutem, duhet të më kuptoni që nuk e kam të lehtë, po kushtet, rrethanat që u krijuan, më detyruan të vij këtu tek ju.

KRYETARJA — Keni ndonjë hall kështu?

NASI — Siç u thashë, e fejuara ime doli vullnetare për një vit në fshat, megjithëse ne këtë verë do të mar-toheshim. Për hir të këtij aksioni kaq me rëndësi që mori ky grup të rinjsh, ne ishim të gjithë dakort që të shtynim martesën. Dhe bëmë shumë mirë, sepse para detyrave kaq të rëndësishme që shtrohen, çështjet vetiake gjithmonë dihet, mund edhe të shtyhen.

KRYETARJA — Po çfarë, ju doni të martoheni tani?... Martohuni meqë e keni vendosur për këtë verë, hiç mos e shtyni. Ne i japim leje Lenës të vijë të martoheni, bile të bëni dhe pushimet dhe pastaj le të kthehet në fshat. (E çiltër.) Mos harroni të ftoni dhe përfaqësues nga fshati se për një vit ajo është vajza jonë.

NASI — Ju falemnderit! Ne martesën e shtymë së bashku me Lenën, po nuk e kam fjalën tek martesë. Këtë detyrohemi ta bëjmë. E kam fjalën gjetkë, si t'ua them, po njeriut në jetë i ndodhin gjëra të papritura... Më kuptoni?

KRYETARJA — Më duket se ju kuptoj: ju të fejuar jeni e tani u duhet të shpejtoni martesën. Apo jo? Këtu nuk ka asgjë për t'u shqetësuar kaq shumë.

NASI — Më shqetëson fakti që, në një kohë fare të papërshtatshme u nis me shumë dëshirë në fshat, me shok e shoqe dhe unë... nuk dua të ndahet prej tyre, po s'ke ç'i bën, ndodhi! (Pauzë.)

KRYETARJA — (E menduar.) Mirë, tani ç'kërkoni nga unë, shoku Nasi, e si mund t'ju ndihmoj?

NASI — Më vjen keq që të tërhiqet Lena nga ky aksi-on me rëndësi, por unë gjendjen jua thashë: ajo nuk mund të vazhdojë të punojë. Është dobësuar e zbehur shumë, sidomos këto kohët e fundit... Ka nevojë edhe për mjekime. Prandaj do t'ju lu-



tem ta dërgoni në shtëpi dhe, meqë u bë puna kë-  
shtu, sigurisht do të martohemi.

**KRYETARJA** — (Mendohet pak.) Meqë çështja qën-  
dron kështu, nuk duam të dëmtohet shëndeti i as-  
kujt, ndonëse njerëzit që na vijnë këtu kthehen në  
shtëpitë e tyre edhe më të shëndetshëm, edhe më  
të fortë, edhe më të freskët, por meqë rasti është  
i veçant, ne sigurisht do ta dërgojmë.

**NASI** — Ju falemnderit! Do t'ju lutem...

**KRYETARJA** — Mos u shqetësoni. Unë do ta thërres  
të fejuarën tuaj dhe do të bisedoj vetë me të.

**NASI** — Do t'ju lutem dhe për një gjë shoqja kryetare.

**KRYETARJA** — Urdhëroni!

**NASI** — Dua të mos i thoni Lenës që këtë ndodhi jua  
thashë unë. Bile nuk do t'i them fare për bisedën  
tonë, se nga natyra ajo është pak krenare dhe nuk  
ia ka thënë njeriu, as së ëmës. I vjen shumë turp...  
Prandaj, ju lutem, gjeni mënyrën se si ta dërgo-  
ni, sepse në gjendjen që është unë nuk dua t'i kri-  
joj asnjë shqetësim


**KRYETARJA** — Mos u shqetëso, se unë do të gjej më-  
nyrën si të flas me të.

**NASI** — Ka të ngjarë që dhe t'ju kundërshtojë, është kre-  
mare djalli! Kam dhënë fjalën, thotë, dhe nuk e  
kthej më. Ka dhe të drejtë, se e ka dhe të vështirë  
të ndahet nga shoqëria. I vjen turp.

**KRYETARJA** — E shoh që jeni i shqetësuar shumë për  
këtë problem. Ikni i qetë dhe kini besim se do  
t'ju zgjidh si duhet.

**NASI** — (Ngrihet dhe i jep dorën.) Ju falemnderit shu-  
më! Ju jam shumë mirënjohës! Mirupafshim!

**KRYETARJA** — Mirupafshim dhe urime për martesën!  
(Nasi del në paraskenë. Duke ecur i thërret një  
fshatari që kalon pranë tij.)



**NASI** — O shok, o shok!

**FSHATARI** — (Nдалон.) Urdhëroni!

**NASI** — Ju lutem, ku është vatra e kulturës këtu?

**FSHATARI** — Hajde se ta tregoj unë. Kërkon njeri?

**NASI** — Kam të fejuarën. Më thanë se pasdite të rinjtë i gjen në vatrën e kulturës.

**FSHATARI** — Po, po! Nuk e kalojnë kot ata: përgatiten për shfaqje dhe u bien kokës mbeturinave e zakoneve prapanike... E di si i kemi këta të rinjtë? Zjarr, or zjarr! Zjarr dhe ne pleqve nuk na lënë të shuhemi. (Duke folur futen në anën tjetër të skenës që s'duken vetëm dëgjohen zërat e tyre.) Ja ku është vatra e kulturës: futu tek ajo dera atje dhe të çon vetë!

**NASI** — Falemnderit e mirupafshim!

**FSHATARI** — Mirupafshim e s'ka përse!

(Një dhomë kulture. Një grup valltarësh, ku bën pjesë edhe Lena, bëjnë provat nën drejtimin e një valltari. Në këtë kohë djemtë që marrin pjesë në valle qëndrojnë në vend kurse vajzat hidhen duke kërcyer nga një krah në tjetrin, pastaj djemtë ulen mbi gju në dysheme, dhe vajzat rrotullohen rreth tyre. Janë katër çifte. Ndërkohë Nasi hyn përgjysmë nga dera që është përballë skenës dhe shikon i vrenjtur. Gjatë rrotullimit Lena e sheh dhe shtanget, pastaj shkëputet, flet diçka pa zë me përgjegjësen dhe shkon drejt tij.)

**LENA** — (I jep dorën.) Mirdita e mirëse erdhe!

**NASI** — Mirëdita e puna e mbarë!

(Të dy dalin para skenës. Në një cep është një stol. Gjatë kohës që ecin për të dalë para skenës ata bisedojnë, dëgjohet vetëm zëri.)

**LENA** — Sa mirë bëre, Nasi! Kur erdhe?

- NASI — Tani sa erdha.
- LENA — Si janë nga të dy shtëpitë? (Ndërkohë dalin para skenës.) Mamaja si është?
- NASI — Mirë janë të gjithë. Po ti si je?
- LENA — Siç më sheh. Lodhemi ca po do të mësohemi. Sa më shumë kalojnë ditët aq më shumë mësohemi.
- NASI — Jo mirë, po qënke «hataja vetë» siç të shoh unë.
- LENA — Pse flet kështu, Nasi?!
- NASI — Hata, pra! Keni ardhur për të dancuar. Apo jo?
- LENA — I bëjmë të dyja dhe punën dhe...le që nuk qe dancim po valle popullore. Po përgatitemi për një shfaqje, provat i bëjmë jashtë orarit të punës, siç e pe dhe vetë.
- NASI — U lodhkeni shumë në punë siç duket, dhe u çlodhkeni duke u hedhur e u përdredhur në krahët e njëri-tjetrit. Kësaj i thonë çlodhje aktive?! (Ndërkohë ulen të dy tek stoli.) Sa çlodhje e ëmbël!
- LENA — Nuk të vjen rëndë që flet kështu, pa u menduar?
- NASI — Unë flas atë që shoh: shoh Lenën për krahu duke u rrotulluar rreth një djali tjetër dhe ai të shikon sikur do të të përpijë. Ja, këtë shoh unë dhe e duroj...
- LENA — Dhe mendoj gjëra të pa qena thuaj!.. Hë, deri ku arrin fantazia! E ç'të keqe pe ti në atë valle? Ne e njohim njëri-tjetrin, punojmë bashkë, hamë bashkë, çlodhemi bashkë, jemi tamam si një familje e madhe.
- NASI — Nuk ka dyshim, vëlla e motër jeni, se keni qenë në një shkollë pa jeni rritur dhe bashkë e këta të tjerët i ke shokë pune e jeni si një familje e madhe. I ke shumë të afërt: të ngrohur në një diell, siç i themi ne!

LENA — (E inatosur.) Ata nuk janë siç i mendon ti, Nasi. Nuk të lë njeri të shkelësh normat e moralit, se pastaj të japin dhe një mësim të mirë për tërë jetën... Po nuk është e para herë që ti më fyen pa të drejtë, për hir të një xhelozie që të ka pushtuar.. (Bën të ngrihet)

NASI — (I hedh dorën në sup.) Po ku ka dashuri ka dhe xhelozia, Lena! Ti e di që unë të dua dhe këtë dobësi e kam timen prandaj mundohu t'i shmangesh që në fillim dhe kështu as ka përse të grindemi.

LENA — E si do të tërhiqesha unë pa një shkak, kur shumica e vullnetarëve, së bashku me të rinjtë e fshatit marrin pjesë në aktivitete?! Pastaj, ti e di, vallet popullore me pëlqejnë shumë.

NASI — (Me të butë.) Mirë, moj mirë, kjo iku tani, por herë tjetër tregohu më e zgjuar, që në fillim.

LENA — (Me të qeshur.) Po, për herë tjetër do t'u them nuk më lë i fejuari. Bile, dhe në aksion nuk deshi të më linte.

NASI — Ti tallesh? Dhe kur dashke t'u thuash, në këtë kohë. Ty edhe po të të pyesin t'u thuash se unë të lutem, por ti vetë nuk do,.. Apo të më këpusin ndonjë fletërrufe në qendrën e punës.

LENA — Sa bukur! Më mëson të gënjej?! Epo, unë s'e bëj kurrë atë! Dhe më duket e çuditshme, ti në shoqëri sillesh njeri i përparuar që e do dhe e përkrah të renë, kurse me mua...

NASI — (E ndërpret, me të urtë) Moj Lena, mos u nxe! Ti je e re... e ndofta dhe unë e teproj, por duhet ta kuptosh që e kam vetëm nga dashuria. .. Nejse, e lemë këtë muhabet! Hajde vemi në klub të pimë ndonjë gjë (I hedh dorën në shpatulla që ta tërheqë për në klub. Lena ngrihet nga stoli. Dalin.)

Tablo e tretë.

Zyra e kryetares së kooperativës. Kryetarja e menduar shëtit nëpër dhomë, troket dera.

LENA — (Duke hyrë.) Mirëdita, shoqja kryetare! Më keni kërkuar?

KRYETARJA — (E qeshur.) Mirëdita, Lena! Po, të kam kërkuar. Ulu, ulu! (Ulet.) Po si je me shëndet, si e ndien veten?

LENA — (E qeshur.) Mirë, shoqja kryetare, shumë mirë!

KRYETARJA — (Pak si e çuditur.) Ashtu?! Po puna si të duket, ke vështirësi?

LENA — Në fillim e ndienim ca më tepër lodhjen, por tani sikur u mësuam.

KRYETARJA — Po pasditet si i kaloni se bujqësia nuk do vetëm krahë, si thoshin dikur po do edhe kë, apo jo?

LENA — Sigurisht. . . Po mirë ia kalojmë, mirë. Më mirë nuk e prisnim dhe kinema, dhe televizor kemi dhe libra sa të duash. Në mbrëmje bëjmë prova në shtëpinë e kulturës e as po e marrim vesh si ikin këto javë. Dhe njerëzit shumë të mirë, sikur na njohin prej vitësh.

KRYETARJA — Ashtu është. Janë të dashur e bujar. . . Dhe tani, dëgjomë Lena: të kam thirrur të bisedojmë dhe ti duhet të më kuptosh drejt.

LENA — Për çfarë e keni fjalën, shoqja kryetare?

KRYETARJA — (E qeshur.) Më thirr Liri, se kur më thua kryetare më duket sikur mban një qëndrim zyrtar ndërsa më shumë jemi shoqe.

LENA — Mirë, shoqja Liri, këtej e tutje do të të flas në emër.

**KRYETARJA** — Po të më dëgjosh edhe si shoqe të vërtetë ama.

**LENA** — Patjetër dhe mos ki aspak dyshim.

**KRYETARJA** — Lena, unë mendoj që ti të kthehesh në familje.

**LENA** — (E trembur.) Mos ka ndodhur gjë andej?

**KRYETARJA** — (E sheh shqetësimin e saj.) Jo, asgjë. Mos u shqetëso, asgjë nuk ka ndodhur! Por puna është se ti... Ti me shokë e shoqe erdhe vullnetarisht të punosh këtu një vit, apo jo?

**LENA** — Po.

**KRYETARJA** — Shumë mirë. Inisiativa juaj është për t'u lavdëruar shumë dhe unë do të të përmendja ty në veçanti. Me gjithë kushtet e tua të posaçme, përsëri vazhdon të mos ndahesh nga shoqëria dhe të heshtësh. Prandaj unë, si shoqe, të them që për ty është më mirë të kthehesh në familje.

**LENA** — (E çuditur.) E cilat qenkan këto kushtet e mia të posaçme që më pengokan që unë të qëndroj këtu, shoqja Liri?

**KRYETARJA** — (Me të mirë.) Dëgjo, shoqe e dashur, unë e kuptoj ngurimin tënd, po ne jemi gra dhe besoj se do të merremi vesh shumë mirë me njëra-tjetrën. Janë gjëra që ndodhin e këtu nuk ka asgjë të keqe.

**LENA** — (Shumë serioze.) Shoqja Liri. Ju lutem, më flisni haptazi se nga kjo e folur në mënyrë të përgjithshme, të drejtën, unë nuk po kuptoj asgjë.

**KRYETARJA** — Ashtu? (Qesh lehtëzi.) Lena, Lena! Ti vetë duhej të kishe ardhur e të më flisje haptazi. Ti e di që gruaja ka misionin e madh të jetës, ri-përtërin jetën. Besoj, më kupton tani, ë?

**LENA** — (E zbehur.) Përgjithësisht, po! Të kuptoj dhe jam dakort po në veçanti përse më fut mua në këto

himne, që duhet t'i thurim gruas?! Dhe, aq më tepër kur nuk ka asnjë arësye?

**KRYETARJA** — (E shikon një copë herë.) Unë, të thash, nuk të flas si kryetare, por si shoqja jote, prandaj s'ke pse të tregohesh kaq fanatike, Lena.

**LENA** — Unë nuk fsheh asgjë nga ty, Liri, por këtu, duket, është ndonjë keqkuptim; prandaj të lutem, më fol hapur.

**KRYETARJA** — Ti je shtatzënë, Lena.

**LENA** — (E habitur.) Unë shtatzënë? (Qesh, por shpejt bëhet serioze dhe e menduar.) Çudi!.. Po si ju paska lindur ky mendim, shoqja Liri?

**KRYETARJA** — (E zënë ngushtë) Jo, hiç! Mos ma merrni për keq.

**LENA** — Jo, shoqja Liri, nuk jua marr për keq, por si doqoftë desha ta di.

**KRYETARJA** — (E kupton lojën.) Lena, a je e fejuar?

**LENA** — Po, jam. U takuat me të? Mos ai.. :

**KRYETARJA** — Po! Dhe m'u lut të mos e bisedoja me ty këtë çështje e të gjeja një shkak, mirëpo diç dyshova, prandaj dhe desha të flas hapur me ty.

**LENA** — Nuk është e vërtetë, shoqja Liri... Kjo nuk është e vërtetë. Nuk ka thënë të vërtetën.

**KRYETARJA** — (Kupton që midis tyre ka grindje). Pa ngrie kokën lart, Lena, shikomë mua dhe më thuaj si e ke hallin? Më kupton? Ama, më fol hap-tazi dhe ki besim tek unë.

**LENA** — Ai nuk duhej të kishte arrirë deri në këtë trillim... Unë e kam vështirë të flas.

**KRYETARJA** — Një grua e kupton më mirë hallin e një gruaje tjetër qoftë kur s'e jeton, Lena.

**LENA** — Nuk ka asgjë të veçantë. U njohëm. në punë, u dashuruam dhe u fejuam. Kjo është historia. Në fillim shkonim mirë.

KRYETARJA — Dhe s'kishit ndonjë fërkim?!

LENA — Po, si gjithë të tjerët, ndonjë fërkim të vogël, që unë e mendoja se i vinte nga xhelozia. Preteksti i grindjeve gjindej lehtë, por e vërteta qëndron në atë që Nasi është ca konservator.

KRYETARJA — Pa shiko se mos të duket, Lena, se që në dashuri e në fejesë t'ju lindin mosmarrëveshje?

LENA — Ah, jo, Liri, jo! Unë përkundrazi heshtja në fillim, bëja sikur nuk ua vija veshin fjalëve, për të mënjeluar qoftë dhe grindjen më të vogël... Dhashë e dhashë, po nuk durova më, rruga e heshtjes m'u duk nënshtrim dhe fillova ta kundërshtoja.

KRYETARJA — Ato janë punët tuaja, Lenë, po shih mos e ke marrë dhe ti rrëmbyer.

LENA — Çfarë rrëmbyer, shoqja Liri?! Ai s'ka dashur që unë të vija këtu në fshat e tani paska kurdisur këtë tjetrën për të më tërhequr me lezet... Dhe ju po të ishit në vendin tim, shoqja Liri, nuk besoj të kishit duruar kaq gjatë... Unë bile mund të them se kjo më dëshpëron aq shumë sa... nuk ta them dot.

KRYETARJA — E ti nuk ke parë gjatë kohës asnjë ndryshim tek Nasi?

LENA — Po si të të them?! Ka dhe ndryshime, po megjithatë... Ai shpesh më jep të drejtë edhe mua për ndonjë gjë që i vë në dukje.

KRYETARJA — Po ja, Lena, kjo ka rëndësi. Domethënë ai të jep të drejtë.

LENA — Po, po.

KRYETARJA — E atëherë duhet të lodhesh më shumë, se ai s'ka se si ndryshon menjëherë. Ndryshimet në sjelljen e njeriut janë të vështira, sepse janë të lidhura me mendimet e konceptet. Në këtë luftë për ndryshime tek Nasi ti duhet të jesh më këmbëngu-



lëse, në mënyrë që të shkoni krah njëri-tjetrit. Më kupton?

LENA — Nuk e di në do të jem e zonja.

KRYETARJA — Nuk e di, po ai më la përshtypjen e një njeriu të mirë. Apo gaboheam?!

LENA — Ashtu është. Ka cilësi të mira. Po si arriti gjer atje, sa të trillojë?

KRYETARJA — E di dhe ti! Mos e zmadho kaq shumë. Unë nuk dua të justifikoj veprimin e tij të padrejtë, se dhe ne gabojmë. Duket të do më tepër se ç'duhet. (Qesh.)

LENA — Jo nuk duhet të arrinte deri këtu...

KRYETARJA — Shiko, Lena! Po të më dëgjosh mua shko ca ditë në shtëpi. Ata të presin. Dhe ti çmалlesh dhe bisedon më shtruar. Nuk bënë keq e s'ke për të humbur asgjë. Bile ke për të fituar dashuri më të madhe.

LENA — Mirë, shoqja Liri, fundja dhe ashtu po e bëjmë. (Ngrihet.)

KRYETARJA — Dëgjo dhe një këshillë para se të nisesh. Të jeshë e matur dhe gjakftohtë. Lëshime mos bëj. Dhe mos harro kurrë: i takon gruas në radhë të parë të luftojë për vete. Mirupafshim!

LENA — Mirupafshim dhe faleminderit! (Del.)

#### Tablo e katërt.

Shtëpia e Lenës. Në divan ulet Maqi, në kolltuk Nansi, në tjetrin Lena e mërzhitur.

MAQI — Hajde, bijë e nënës, ulu këtu në divan të çlodhesh, pa pastaj fjalosemi më gjatë.

LENA — Jo, jam më shumë e mërzitur se sa e lodhur!

MAQI — Po rruga e gjatë, moj bijë, të lodh e të mërzit. Pa në bujqësi edhe puna nuk është e lehtë e sidomos për ty që nuk je mësuar.

LENA — Po mësohem, nënë, s'ka gjë që s'bëhet. Pastaj puna në natyrë të jep dhe kënaqësi.

NASI — (Me ironi). Po, po, edhe çlodhjen e bëjnë shumë të kulturuar, bile më mirë nga ne këtu.

(Lena e sheh me inat Nasin, po nuk flet.)

MAQI — (S'kupton gjë.) Po ka ndryshuar fshati, mor bir! Njëherë rronim me kandile, kurse tani jemi me drita elektrike, pa le të tjerat...

NASI — Ashtu është vërtet, po tani të vijnë dhe tek çështja jonë. Ardhja jote është e rëndësishme, Lena.

LENA — (E prerë.) Përderisa u bë puna ashtu, sigurisht që do të vija.

MAQI — Po ç'ke, moj bijë e nënës? Ne gëzojmë që erdhe, ti na flet tërë inat.

LENA — Mama, të lutem na lër pak vetëm.

MAQI — Mirë të keqen, nëna, ju le unë.

(Duke dalë flet me vete.) Dhe unë, hiç mëndja... Ata janë të rinj dhe helbete. U plaka, u plaka! (Del.)

NASI — Erdhe si erdhe, rëndësi ka që erdhe.

LENA — Ardhja vërtet që ka rëndësi.

NASI — Moj Lena, ç'ke kështu? Pse na bën lodra fjalësh?

LENA — Lodra fjalësh? Unë nuk bëj lodra fjalësh, ato i bën ti. Dhe më e bukura është se i bën pas kurri-zit tim.

NASI — (Me autoritet.) E ç'do të thuash me këtë?

LENA — Si ç'dua të them, more?! Kush ta dha të drejtën ty të më përdorësh mua si mburojë për të shpënë në vend dëshirat e tua.

NASI — Aha! Të paska hapur zemrën kryetarja, duket!  
Sa mirë!... E po, gruaja sado ta mbajë fjalën, sa  
një grua do ta mbajë. Apo jo?

LENA — Ou?! Dhe ti ke të drejtë të fyesh, se të doli në  
shesh një... një... një... Më erdhi turp, më er-  
dhi! Megjithatë ajo s'bëri tjetër vetëm se përsëriti  
ato që i the ti. Dhe për këtë qenka fajtores?! Çu-  
di! Dhe ti paske të drejtë edhe ta kritikosh.

NASI — Dëgjo, Lena, leri këto tani se s'kanë më rëndësi.  
Qëllimi ishte që të vije ti, dhe mua kështu m'u dha  
të zgjedhë këtë rrugë. Kjo m'u duk më e drejtë  
për t'u tërhequr me lezet, gjë tjetër nuk më ra  
ndër mend. Më kupton?

LENA — Dhe këtë e bëre pa më pyetur mua, ë?

NASI — E ç'ishte nevoja?!

LENA — Po unë nuk do të të lejoja, Nasi.

NASI — Nuk kisha ku të të gjeja... Pastaj, më takon-  
te mua të zgjidhja.

LENA — Edhe çështjet e mia? Me ç'të drejtë?

NASI — Edhe çështjet e tua.

LENA — Pa më pyetur mua?

NASI — Ç'po e zgjasim kot Lena! Jo me ç'të drejtë, pse pa  
mua. Oh dhe ti! E zgjidha unë me të drejtën e burrit.  
Ja, ç'do më?

LENA — (E shqetësuar, lëviz nëpër dhomë.) E drejta e  
burrit, që ti ia ke dhënë vetes. Paskë të drejtë të dre-  
jtosh dhe fatin tim e të diktosh edhe rrugën time...  
Dhe unë?!... Ogiçja që duhet të të vij ty nga pas si  
manare qoftë edhe në se më poshtëron. Sa keq, Na-  
si, kur jeta e gruas mblidhet vetëm në kanunin e  
burrit...Oo, mbetet vetëm në dorën e burrit, desha  
të them. Atëherë ajo ka vdekur shpirtërisht, Nasi  
...ka vdekur. Këtë kërkon ti?

NASI — Nuk është ashtu dhe mos i trash gjërat kot së koti! Sa për gruan në përgjithësi unë e vlerësoj. Dhe aq më tepër ty... Por duhet të kuptosh një gjë veç, se gruaja, me gjithë virtytet e bukura e të mira në natyrën e vet, ka nevojë edhe për ndihmën e burrit për vete vështirësitë që i krijojnë asaj në zgjidhjen e problemeve... Si ta them, vetë natyra...

LENA — Ashtu?! Po burri?!

NASI — Ndryshon burri, Lena, ka të tjera cilësi. Ai ka ashpërsinë, vendosmërinë, ka...

LENA — Ka, Nasi, ka, po jo trillimin... Për turp!

NASI — Lere tani! Prapë ti?! Unë ku ta gjeja që dikush të më zgjidhte punët. Dhe ky do të ishte një favor, ndërsa ti, hä! Nuk e pranon.

LENA — Aq sa do të pranoje ti të drejtat e mia mbi të drejtën tënde. Ne jemi bashkëshort, apo jo?!

NASI — Po!

LENA — Dhe kemi të drejta bashkëshortore.

NASI — Po!

LENA — E kur cënohen këto të drejta?!

NASI — Askush nuk t'i ka cënuar.

LENA — Cënohet dhe dashuria, fillon të zbehet, Nasi, dhe ftohet sado e fortë të ketë qenë ajo. Kështu?!

NASI — (Me inat.) Dhe të gjitha ndaj të vërtetës jetësore mbeten filozofi të mësonjësve.

LENA — Ashtu?

NASI — Kryesorja është që ti u ktheve!

LENA — Ndërsa për mua, tjetra: ti gënjeve!

NASI — Ou, dhe ti! Fundja, për ty! Dhe nuk përmbysa botën?!

LENA — Unë do të kthehem përsëri në fshat.

NASI — (Brof në këmbë i inatosur.) Atje nuk ke për të vajtur më, Lena! Besoj se po ta them qartë: nuk ke për të vajtur! Dëgjove? Nuk ke për të vajtur!

LENA — Dhe unë të fola qartë. Do të shkoj!

NASI — (Bën lëvizje nëpër dhomë, pastaj i afrohet Lenës.) Moj, ti ke luajtur mënç? Unë mundohem të të heq nga fshati, bile pa të dëmtuar, që edhe para shoqërisë të jesh e shfajësuar edhe të mos biesh në sy, edhe...

LENA — Edhe...

NASI — E ti mbledh mendjen se nuk e ke mirë. Dhe jepi fund këtij muhabeti. Në fshat nuk ke për të vajtur, se ne do të martohemi. Dhe pikë!

LENA — Dëgjo, Nasi! Nuk të lejoj më që të sillesh me mua si të duash, e të më fyesh kur të duash.

NASI — Unë nuk po të fyej, po të shpjegoj... Po ti nuk do të kuptosh?

LENA — Ç'të kuptoj, Nasi?

NASI — Dashurinë time për ty.

LENA — Po, sipas mënyrës sate.

NASI — Unë nuk kam ndonjë mënyrë të veçantë në dashuri.

LENA — Ke. Ja, nuk do një vajzë që të guxojë e të shkojë në fshat një vit kur ajo është e fejuar, me një fjalë do një vajzë që të mos guxoj të të kundërshtojë. Dhe këtë mendove se e gjete.

NASI — Dëgjo, Lena! Ti je e re shumë dhe nuk mund t'i kuptosh menjëherë të gjitha proceset që kalojnë marrëdhëniet e një çifti.

LENA — Çfarë marrëdhëniesh?!

NASI — Ja, këto, marrëdhëniet fyese që po më bënë dhe këto icklat, që po mundohesh ta shtysh sa më tepër martesën. (I vë dorën në mjekër dhe i ngre kokën Lenës me nervozizëm.) Pa më shiko! Apo mos ndonjë bukurrosh?...

LENA — Si guxon! (I heq dorën me nervozizëm.)

NASI — Guxoj në atë që ti nuk do ta thuash.

LENA — Çfarë pune, Nasi!

NASI — Në atë që ti nuk do të bindesh. Më kryesoren, në martesën... Dhe më kapesh pas cingrash jo pse thashë kështu unë e pse s'thashë ashtu. Diku gjetkë duhet të jetë halli, ndryshe nuk ka si shpjegohet.

MAQI — (Hyn e shqetësuar.) Nasi, të lutem!...

LENA — Ik, Nasi, ik! U bëre i tepërt në këtë shtëpi.

MAQI — Mos bijë, mos u nxito!

NASI — (Niset të ikë dhe tek dera qëndron.) Kështu, pra, këtë deshe të arrish dhe e arrite nën maskën për të shkuar në fshat. E pacipë! (Del.)

## PJESA II

### Tablo e pestë

Shtëpia e Nasit. Një dhomë ndenjeje e rregulluar me kujdes. Në divan duke pirë duhan është ulur Andoni. Vasilika hyn e del duke bërë punë.

VASILIKA — Hajde, Andon, bjer se vajti vonë!

ANDONI — Bjer, ti bjer!

VASILIKA — Ora 11, ç'pret më?!

ANDONI — Do të pres Nasin. Kam për t'i thënë nja dy fjalë.

VASILIKA — E, dhe ti! Për natë s'ke punë tjetër po...

Nuk është më i vogël Nasi, prandaj hajde bjer.

ANDONI — I vogël nuk është po ama gabime bën.

VASILIKA — Ja ke thënë, mor Andon, njëqind herë ia ke thënë.

ANDONI — Dhe një mijë herë do t'ia them, sa të vijë në vete.

VASILIKA — Hajde tani. Po, dhe në gaboi, i ri është.

ANDONI — I ri, po të nxjerrë mësim e të mos më vijë vonë, nganjëherë edhe i pirë. Ku vete? Ku pì ai?

VASILIKA — Mos, o Andon, mos! Nuk i mjaftoi gjithë ajo mbledhje po edhe ti tani...

ANDONI — Nuk ka zënë mend, grua! Ja kështu : sa ishte në repart më dukej më i shtruar, po, hë! Na u rrit djali me të kaluar në byronë teknologjike, sikur iu rrit mendja djalit. Po të kthehet dhe një herë atje ku qe dhe ta shohi atë mendjen e vet.

VASILIKA — E pse?! Sikur atje nuk po bënë punë ai.

ANDONI — Punë, punë po jo aq sa duhet. Nuk e kam parë një herë të rrijë mbi libër, të lexojë, të vizatojë. Apo jeton me ëndrrën se e morën si mekanik të mirë e i kanë nevojën e ky ia këput gjumit.

VASILIKA — Nuk di unë, po kaq di të them: mos i bjer në qafë, se ke një huq ti, që kur të vihesh dhe nuk vë re më.

ANDONI — Më mirë ta rregulloj unë, në qoftë se të tjerët do të kujtohen më vonë, se fundja unë e kam djalë.

VASILIKA — Dhe ata e kanë punëtor.

ANDONI — Mua më dhemb më shumë, të thashë.

VASILIKA — Shiko, për kokën tënde, lëre në hallet e veta djalin, se dhe kjo i duhet atij... sikur s'i mjaftoi ajo shejtankë vajzë, që ia punoi. Na dhe ti.

ANDONI — Ajo nuk i ka faj.

VASILIKA — (Bie dera. Ngrihet të hap derën.) Dëgjo, Andon, lëre sonte mos i folë!

NASI — (Hyn.) Mirëmbërëma!

VASILIKA — Mirëmbërëma, bir! Erdhe?

ANDONI — (Serioz.) Mirëmbërëma!

(Nasi ulet në një kolltuk, kurse Vasilika hap një raft për të nxjerrë diçka për të ngrënë.)

VASILIKA — Hajde, Nasi!... Ulu të hash darkë!

NASI — Jo, nënë, nuk më hahet.

VASILIKA — (Pak e trembur.) Pse, mor bir, mos je sëmurë?

NASI — Jo, kam ngrënë.



VASILIKA — Ku ishe, në ndonjë gosti?

NASI — Jo, isha me shokë.

ANDONI — Pse të papunë jeni ju që sorollateni deri në këtë orë, natën?

NASI — Sigurisht, nuk jemi të papunë, po, pas tetorëshit, kohën e lirë do ta shfrytëzojmë si të duam.

ANDONI — Për shembull duke pirë e duke bredhur... Të bukur shokë!

VASILIKA — E po dhe ti!... Nuk vjen përherë vonë ai, jo... Ja, hera e parë.

(Ia bën me shenjë të pushojë.)

ANDONI — Hera e parë?! Sa humbet kohën kot, pse s'rri më ofiçinë të përfitosh sa më shumë.

NASI — Nuk e kam punën për ofiçinë unë, baba, jo!

ANDONI — Ashtu?! Pse s'lexon atëherë... Ti sikur deshe të fillosh dhe universitetin. Apo kjo s'ka të bëjë me kohën e lirë...

VASILIKA — (Ia pret fjalën.) Epo mjaft, more Andon, i fole djalit, mjaft! Ti e di që është i mërziur, mos e rëndo më tepër.

ANDONI — (I revoltuar.) Kush ia shkaktoi mërzinë, moj, unë apo ti?!

VASILIKA — Ajo shejtanka, ajo! Ku vajti dhe e njohu.

ANDONI — Të thashë, ajo nuk i ka faj! Prandaj rri shtrembër dhe fol drejt, grua! Atë nuk e kemi gjë, po ajo qëndron lart këtij, djalit tonë. Dhe ky duhet të përfitojë nga ajo. Kaq di të them unë. (I drejtohet Nasit.) Dëgjon? Dhe ti duhet t'i japësh fund kësaj gjëndjeje.

NASI — Ju nuk keni pse të shqetësoheni kaq shumë.

ANDONI — (I nxehur.) Oj?! Bandilli i babit! E çfarë tjetër do të bësh ti?! Punës nuk po ia vë veshin, natën vjen, te e fejuara nuk vete. Djalë!... Ç'ke ndër

mend të bësh tjetër që të mos shqetësohemi kaq shumë për ty.

VASILIKA — Lere, de, lere! Djalë, djalë! Ai mendje prishur dhe ti... Ia prishi mendjen djalit.

ANDONI — Vetë e ka prishur mendjen dhe ti mos e shty më tej, se pastaj do të kërkosh djalë, por ëhë! S'do ta kesh më.

NASI — (Ngrihet të ikë.) Më mirë e mbyllim këtë bisedë. Natën e mirë!

ANDONI — Ku vete?

NASI — Jam i lodhur, do të bie.

ANDONI — (Me autoritet.) Rri aty!

VASILIKA — Lere, de! Ai thotë jam i lodhur, ti...

ANDONI — Lere, posi lere! Mos do edhe ta tundim para se ta vemë në gjumë? Ulu aty dhe dëgjo.

NASI — Ç'të dëgjoj?! Për natë po këto muhabete. U mër-zita.

ANDONI — (I revoltuar.) Po ti me ato sjelljet e tua nuk na ke mërzitur? pa pyete veten?

NASI — Nuk shoh ndonjë gjë kaq shqetësuese sa... Në fund të fundit djalë jam, mor baba!

ANDONI — Oj?! E pastaj, kush qenka djalë mund të bëjë ç'të dojë, ë?! Shiko, t'i japësh fund kësaj gjendjeje...

NASI — Këto janë çështje që do t'i zgjidh vetë. Ju rrini të qetë, e më mirë mos u përzieni fare.

ANDONI — (I nxehur.) Ne na del gjumi natën për ty dhe ti na thua të mos përzihemi. Po kujt ia thua këto, mua apo asaj? Harron ti se quhesh i biri i Andon Ilias?! Dëgjon apo jo? Je i biri i Andon Ilias që tërë jetën ka punuar me nder, prandaj, sa të jem gjallë unë, ti do të mbetesh i biri i Andon Ilias, se nuk të lë të ma njollosësh emrin. Dëgjon?!... Prandaj... (Nasi do të flasë). Prit të flas unë! Mblidh

mendjen, përndryshe në shtëpinë time s'ke më vend.

NASI — Në qoftë se ju jam mërziur kaq shumë që nesër po shkoj në hotel të beqarëve.

VASILIKA — (Ngrihet, shkon tek djali.) Po ç'të bëri djali ty?... Je në vete ti, dashke të ma përzeshe dhe nga shtëpia? E pse?! Nga një... një... një... nga ajo çupërlina Oj, shalëthata, ma bëri djalin në këtë ditë!

NASI — Lëre këtë muhabet, mama!

ANDONI — Jo, jo, kjo është kryesorja. Duhet t'i japësh zgjidhje. Që kur ke acaruar marrëdhëniet me Lenën nuk je më ai i pari. Dëgjon? Të flet njeri keq për të?

NASI — Jo!

ANDONI — Ka bërë ndonjë gjë të pandershme?

NASI — Jo!

ANDONI — Po atëherë pse i sillesh kështu?

NASI — Ti e di mirë si u zhvilluan ngjarjet.

ANDONI — Dhe unë ta kam thënë e ta them se ti je fajtor.

VASILIKA — U?! Ato janë tërbuar e ky qenka fajtor?!

ANDONI — Pse moj qenkan tërbuar ato?

VASILIKA — Ja, ndiqet burri nga shtëpia? Turp e përfaqe të zezë, nuk ka bërë vaki! (I drejtohet Nasit.) Uh, dhe ti, ç'e ke humbur! Ishin burrat njëherë, që kur hynin brenda tundej shtëpia. Kështu, de, dhe mblihd mendjen se nuk mbeti Stambolli për gjilpëra.

ANDONI — Mend të bukura i jep, grua! Jepi, jepi! Ajo është vajzë me të gjitha të mirat.

VASILIKA — Që kur je bërë kaq dorë lirë, mor burrë. Si të duket ty, të ikë nusja vullnetare pa pëlqimin e të shoqit? Apo ka vullnetar andej.

ANDONI — Rri, e mos fol gjepura, grua, se në vend që ta dihmosh, po e merr më qafë, tët bir!

VASILIKA — Po, po, njëherë e një kohë ti nuk më lije të dilja as tek porta, e tani nuk pyetke as për në fshat... Po dhe tët bijë ta kishe nuk do t'i dilje kaq për krah.

ANDONI — Ç'flet, moj Vasilikë! Tjetër kohë, të tjerë njerëz; ndryshuan kohët, ndryshuan njerëzit, ik e fli më mirë që të kthjellosh mendjen e të mos flasësh turbull.

VASILIKA — Iki unë, iki, po... siç e keni zënë ju, as në mëngjes nuk mbaroni. (Duke ikur flet me vete.) Tani burrat janë bërë si gratë... apo jo! Më mirë do thënë gratë si burrat, se ato tani nuk po pyesin... koha e grave kjo... Natën e mirë!

TË DY — Natën e mirë!

ANDONI — (Me të butë.) Pse hesht, mor bir?! Je i turbulluar, a je i pavendosur, të mundon gjë, a të fryn njeri në vesh? Foli babait. (Andoni ngrihet, i afrohet të birit i ngre kokën.) Shikomë në sy!

NASI — Më fole ashpër, baba.

ANDONI — Unë të kam fëmijë! Dhe gjithmonë prindi fëmijës i fletë butë, se vuan më shumë nga ç'thonë... Nuk ia nxjerr të gjitha goja se i dhimset pjella, se mërzitem më shumë se mërzitesh ti, se lumturohem më tepër kur je i lumtur ti. Ja, ti i folle kryetares, unë, babai yt nuk kam sy e faqe t'i dal përpara syve. Ndërsa ti e quajte bisedë të lehtë.

NASI — Ndofta vajtja qe e nxituar, baba, por për të tjerat nuk ke të drejtë.

ANDONI — Që në fillim gabove. Nuk kishe të drejtë ti, që ta ndaloje të shkonte në fshat. Ta marrim shtruar: ajo deshi të shkonte në fshat, ti deshe ta ndaloje. Sikur t'ia thoshje njerëzve këtë, kujt

do t'i jepnin të drejtë, ty apo asaj... Bile, ajo ka vepruar me mend se kundërshtimin tënd nuk ia tha njeriu; ndërsa ti, për turp, vajte e ia paraqite kryetares, po jo drejt-drejt — akoma më keq. Fol tani, kush ka faj, ti apo ajo, Lena? Sikur ajo të të ndante nga shokët.

NASI — Vështirë do ta kisha!

ANDONI — Atëherë?... Kështu duhet të gjykosh.

NASI — Një gjë më shqetëson, baba! Unë ende nuk e kuptoj përse ajo këmbënguli që të kthehej përsëri në fshat.

ANDONI — E përse të vete mendja ty?! Dyshon?!

NASI — Me thënë të drejtën... fjalë të mira kam dëgjuar.

ANDONI — Tregohu më i pjekur, Nasi, se s'je kalama.

Të takon ty t'i japësh zgjidhje kësaj çështjeje. I ri je dhe i mirë je, po në disa gjëra nuk ke të drejtë.

NASI — Ti nuk e di, ajo më ndoqi nga shtëpia atë natë.

ANDONI — I di, i di. Të gjitha i di... Po vonë të paska ndjekur, duhet të të kishte ndjekur më herët. Me atë që i ke punuar ti asaj... Shko e kërkoi ndjesë, në të pranofte.

NASI — E kam të vështirë.

ANDONI — Ah, ajo sedra jote prej burri e ka të vështirë! Dhe dëgjo mua. Në do të shkosh jetë me të, mos u përpiq ta nënshtrosh. Ti duhet të këshillohesh... Ç'të bëjmë ne, të moshuarit, pa këto të rejat e sotme janë ndryshe. Gratë e hershme lindnin e vdisnin të nënshtroara, pa këto... Hajt, Nasi! Për punë të mira asnjëherë nuk është vonë.

NASI — Më merren mendtë, baba. Jam turbull.

ANDONI — E po, bjer fli! Dita e re, mendje e re. Natën e mirë! (Ikën.)

NASI — Natën e mirë!

## Tablo e gjashtë

Shtëpia e Nasit. Dhoma po ajo e para. Hyn Nasi, hap derën dhe ulet i mërzitur në divan.

NASI — (Flet me vete.) Po këta ku do të kenë vajtur? (Hedh sytë mbi tavolinë dhe merr një copë letër.) «Nasi, jemi tek Fatimja, po mbarove shpejt nga mbledhja, hajde, Luljeta». Po, moj motër, po, atë mendje kam unë. Hajde, thotë, më merr! Unë jam bërë për vete të më marrë!

(Troket dera. Nasi ngrihet, hap derën.)

ARBENI — Po sa shpejt ike, more Nasi. Të kërkova sa mbaroi mbledhja e ti dhe erë t'ishe bërë s'do të ishe zhdukur kaq shpejtë.

NASI — (I mërzitur.) Ç'më doje?

ARBENI — Si more ç'të doja?! A nuk na ka ftuar Iliri për ditëlindjen e djalit?

NASI — Ouu, të betohem që më ka dalë nga mendja fare! Megjithatë nuk vij.

ARBENI — Ho, ho, ho! Nuk na ardhka! Si ta marrë këtë apo të...

NASI — Joo, jo! E kam me tërë mend. Nuk jam në humor.

ARBENI — Ç'flët, more! Atje të presin të gjithë e ti...

NASI — Nuk jam në humor, Beni.

ARBENI — Prandaj hajde me ne. Se dhe në mbledhje të pashë mjaft të mërzitur.

NASI — E si mos mërzitem? Ishte një rast shumë i mirë. Dhe ata sikur nuk e dinë që në fshatrat e asaj zone unë kam të fejuarën. Duket haptazi që kanë humbur besimin. Tjetër emër nuk ke ç'i vë kësaj.

ARBENI — Ti e thua këtë se asnjë tjetër nuk e tha. Kur u kërkuan dy mekanikë për mirëmbajtjen e makinave bujqësore, pse s'dole vullnetar?

NASI — (I habitur.) Unë të dilja vullnetar!? E pse, apo të dukesh unë mbi të tjerët? Ata i kishin caktuar dy vetë e mua nuk më mbetej t'u dilja në rrugë. Po të donin ata më caktonin dhe mua, por duket s'deshën prandaj heshtën...

ARBENI — Të siguroj unë që në këtë mes nuk ka asgjë me qëllim të keq. Megjithatë u themi të zëvendësojnë njërin prej tyre me ty. Hajt, punë që rregullohet dhe kjo. Çohu tani!

NASI — Në asnjë mënyrë dhe as që duhet bërë ky zëvendësim. Të shkoj unë e t'u lutem... Jo, ore vëlla, jo!

ARBENI — E po edhe ata s'hodhën fall se ti doje të shkoje patjetër këtë herë. Fundja, nisu vetë, nësër pushim e ke.

NASI — Do të ishte më mirë të shkoja me punë.

ARBENI — Pse?

NASI — Të them të drejtën më vjen rëndë. Po dhe kryetarja e di e ndonjë tjetër mund ta ketë marrë vesh... Bile, edhe prej Lenës kam një farë drojtjeje. Prandaj thashë, se po të veja me punë, besoj se do ta kisha më të lehtë.

ARBENI — Më të lehtë e më të rëndë... sa më shumë ta zgjatësh aq më të vështirë do ta kesh. Prandaj, hë! Sa më parë. Dhe Lena me siguri të pret. Më thanë se e kanë bërë dhe brigadiere, pa le. Ka dalë e dalluar.

NASI — E di.

ARBENI — (Duke qeshur.) Si të erdhi kur e more vesh?

NASI — E pse qesh? Mirë më erdhi.

ARBENI — Jo thashë, mos deshe të të pyesnin edhe ty përpara se ta bënë brigadiere.

NASI — Pse, kur e bënë Vjollcën drejtoreshë të pyetën ty?

**ARBENI** — Mua?! Hë! Ajo erdhi në drekë e tronditur se as na e priste mendja që nga punëtore ta bënë drejtoreshë fabrike dhe ti thua të më pyesin... Jo, ore, jo. Ç'na polli, thashë me vete, të heqësh dhe telashet e gruas, kjo është ç'është. Megjithatë s'i thashë gjë, po ajo e kuptoi ama. Më tha: Po ti pse më shikon ashtu, s'ke besim se e bëj, ë? Jo, jo s'është aty puna, po a u the që je shumë e zënë, që ke tre fëmijë dhe ndoshta s'e përballon dot gjithë këtë ngarkesë — i thashë unë. Ata i dinin të gjitha, megjithatë e kishin emëruar drejtoreshë. Dhe po ia del mbanë. E drejton shumë mirë fabrikën. Punon edhe atje edhe në shtëpi si më përpara. Çuditëm, ku i gjejnë gjithë këto forca, mor burrë i dheut. E di ti që ne nuk i njohim sa duhet vlerat e tyre? Ato punojnë e drejtojnë si me burrat, në mos më mirë.

**NASI** — Jo të gjitha...

**ARBENI** — Po pse, mos të gjithë burrat kanë aftësi drejtuese dhe organizuese. Rri, o Nasi, për kokën tënde. Vështirësia qëndron këtu (I bie kokës me dorë.) se ne nuk luftojmë sa duhet me vetveten dhe me njëri-tjetrin për të shkukur ato mendime të padrejta që kemi në mendje për gruan. (Shikon orën.) Ou, iku ora! Pa çohu tani se për gratë mund të flasim tërë natën e prapë as ty as mua të mos na mbushet mendja.

**NASI** — Nuk vi jo! Do t'i vete ndonjë ditë tjetër, po sonte jo! Mos m'u lut.

**ARBENI** — Apo ke bërë ndër mend të shkosh me Lenën? Po qe kështu...

**NASI** — Shko, shko, nuk i dihet!

**ARBENI** — (Duke ikur.) E po, natën e mirë!

**NASI** — (Tek dera e përcjell.) Natën e mirë!



(Ulet merr një letër e penë e fillon shkruan.) S'më ecka dora fare, po pse vallë, ajo as më shikon as më dëgjon. (E mbledh shuk letrën, zë kokën me të dy duart dhe rikujton. Në këtë çast dëgjohet zëri i të atit.) Atë s'e kam gjë, ty të kam, po ajo qëndron lart teje. Ti duhet të marrësh shembull prej saj.

(Dëgjohet zëri i Lenës.)

Çfarë të drejte ke ti mbi mua? Ti ke aq të drejta mbi mua sa kam unë mbi ty. Këto janë të drejtat bashkëshortore. Dhe kur cënohen këto lidhje, dashuria dëmtohet, fillon të zbehet, të ftohet sado e fortë të ketë qenë ajo.

(Dëgjohet zëri i Arbenit.)

Dëgjo, Nasi. Sa më shumë ta zgjatësh aq më vështirë do ta kesh. Prandaj he, sa më parë. Dhe Lena me siguri të pret.

### Tablo e shtatë

(Një sallë e madhe e mbushur me fshatarë të ulur aty këtu, me vegla pune në duar. Hyn kryetarja e kooperativës. Bëhet zhurmë.)

**KRYETARJA** — Mirëmëngjesi, shokë. Dëgjoni, mos humbasim kohën. Do të bëjmë një rindarje të re të punës, derisa të rregullohet autokombajna e sektorit të parë. Jemi në kohë fushate. Në tërë rrethin kjo fushatë është shpallur aksion politik dhe kështu duhet ta kuptojmë. Në qytet i është dhënë një rëndësi e madhe. Komiteti i partisë së qytetit

na lajmëroi se do të na dërgojnë forca vullnetare nga qyteti. Kjo është një ndihmë e madhe për ne. Megjithatë ne duhet të vazhdojmë punën duke u mbështetur në forcat tona.

Meqë autokombajna këto ditë, siç më thanë mekanikët, mund të mos riparohet, pasi ka difekt të rëndë, dy brigada, e para dhe e treta do të përqëndrojnë forcat këtej përroit, pasi në këtë sektor tani për tani do të korret me dorë. Autokombajnat do të vazhdojnë punën në dy sektorët e tjerë, përtej përroit ku do të përqëndrojnë forcat brigada e dytë dhe e katërt. Qartë, shokë? Tani përgjegjës në sektorin e parë për fushatën e korrjeve do të jetë Lena. Në sektorin e dytë Petriti dhe në sektorin e tretë Bardha. Dëgjoni, shokë, mos humbasim kohë. Përgjegjësat të më japin që tani gjendjen reale të forcave për të tre sektorët dhe çdo mbrëmje do të më raportoni për gjëndjen. (Pauzë.)

**LENA** — Në sektorin e parë janë 85 forca. (Kryetarja shënon në bllok. Ndërkohë tek dera hyjnë disa fshatarë pleq.)

**PENSIONISTI I** — Shëno 100 forca në grupin e parë. Jemi gjallë akoma, shoqja kryetare, paçka se s'na llogarisni ju.

**KRYETARJA** — (Ngre kokën, buzëqesh.) Jo, xha Abaz, ne ju duam e ju respektojmë, po ju jeni në pension s'ju detyron njeri.

**PENSIONISTI II** — Ashtu është, moj bijë. Tërë jetën kemi punuar, po kemi hequr dhe vojtje të mëdha! Tani po na çlodhen kockat dhe po shikojmë ditë të bardha. Rrimë në shtëpi e kooperativa na paguan, më përpara kur punonim për të tjerë na hiqnin dhe këmishën nga trupi. Na hanë duart për punë. I thonë bukë asaj, o lale... Apo flas gabim?

PENSIONISTI III — Prandaj sa herë të ketë fushata do të na llogaritësh edhe me pensionistëve në forca pune.

KRYETARJA — Që këtej e tutje do t'ju quajmë grupi vullnetar i aksioneve të mëdha. (Të qeshura.) Vazhdojmë, shokë, forcat e sektorit të dytë sa janë, Bardha?

BARDHA — 50 veta.

(Nga jashtë dëgjohet zhurma e një autokombajne që punon.)

KRYETARJA — Ç'është kjo autokombajnë? Thamë se këtu tani për tani do të korret me dorë. (I drejtohet një djali.) Dil u thuaj që të tërë autokombajnata të kalojnë matanë përroit. (Ndërkohë hyn një mekanik.)

MEKANIKU — (I gëzuar.) U rregullua, u rregullua autokombajna.

KRYETARJA — (E habitur.) Vërtet? Si? Shumë mirë! Ju lumtë!

MEKANIKU — Të lumtë i thoni atij mekanikut nga qyteti. Ç'djalë që është, apo si mekanik, i mbaruar. Ka tërë natën me ne.

KRYETARJA — Po ku e gjetët?

MEKANIKU — Fare rastësisht. Ka ardhur se ka nusen këtu. Kaloj andej, na gjeti ne duke punuar në autokombajnë dhe iu përvesh punës bashkë me ne deri sa u gdh. Tani po provon autokombajnën.

KRYETARJA — Çojeni në mensë të hajë e të çlodhet.

MEKANIKU — Pushoi autokombajna. Po vjen. (Në derë hyn Nasi me dy fshatarë të tjerë. Të gjithë drejtojnë shikimet nga dera. Lena shtanget.)

KRYETARJA — (E qeshur i afrohet Nasit dhe i zgjat dorën.) Mirë se erdhe, shoku Nasi, mirë se erdhe.

Ke ardhur si me porosi, tamam atëherë kur duhe-  
she më shumë se çdo herë tjetër.

NASI — Mirë se u gjeta, shoqja Liri. Kështu mendoj dhe  
unë. (I drejtohet Lenës. Lena ndërkohë është afru-  
ar te Nasi.) Si je, Lena? (I zgjat dorën, kurse tje-  
trën ia hedh mbi sup.)

LENA — (Pak e tronditur.) Mirë, Nasi, po ti se je?  
(Ndërkohë janë shkëputur pak nga të tjerët dhe  
i janë afruar skenës.)

NASI — Më mirë se çdo herë tjetër.

LENA — Do të rrish disa ditë?

NASI — Sa të mbarojmë fushatën e ndofta dhe më shumë  
po të më lejojnë.